



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Agjencia e Statistikave të Kosovës shpallë: KONKURS TE MBRENDSHËM për këtë vend punës:

Departamenti i Statistikave të Llogarive Kombëtare dy (2) pozita të karrierës

Titulli: Një (1) Drejtor të Departamentit të Statistikave të Llogarive Kombëtare

Numri i referencës : ASK-DSLK-001

Koeficienti : 10

Detyrat kryesore:

1. Bën menaxhimin dhe organizimin e punëve të Departamentit të Llogarive Kombëtare, përgjegjës për planifikimin, realizimin, dhe mbikëqyrjen e politikave të departamentit (realizimi i planit sipas afatit kalendarik, implementimi i klasifikimeve të reja sipas planit vjetor të paraparë, përmirësimi i kualitetit përmes aktiviteteve shtesë të kontrollit me raporte).
2. Udhëheqë punët në përgatitjet e programit dhe planit operativ të hulumtimeve statistikore, bënë planin njëvjeçar të punës dhe përgatitë programin pesëvjeçar të punës.
3. Mbikëqyrë të gjitha fazat statistikore (përgatitjen e instrumenteve statistikore, grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore).
4. Vë në shfrytëzim klasifikimet, standardet dhe metodologjitë e Eurostat-it për zhvillimin e statistikave për Llogaritë kombëtare dhe qeveritare, për të dhënat për ekonominë e pavarë, si dhe jep propozime për avancimin dhe azhurnimin e Llogarive Kombëtare.
5. Siguron krahasueshmërinë e të dhënave statistikore të Kosovës me ato ndërkombëtare.
6. Bën vlerësimin kualitativ të të dhënave nga publikimet dhe kujdeset për aftësimin profesional të stafit. Mbikëqyrë në kohë të gjitha materialet e përgatitura për publikim sipas planit dinamik.
7. Përgatitë raportet e punës javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore.

8. Kryen detyra të tjera shtesë sipas kërkesës së KE.

Kualifikimi : Diplomë universitare nga Fakulteti Ekonomik.

Përvoja e punës: kandidati duhet të ketë 7 vite përvojë pune dhe atë 4 vite përvojë pune në vende udhëheqëse.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Të menduarit strategjik lidhur me planifikimin dhe menaxhimin,
- Njohuri mbi indikatorët makroekonomik,
- Të ketë shkathhtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë,
- Shkathhtësi të dëshmuara të zhvillimit të mbajtjes së trajnimit, instruktimit dhe monitorimit,
- I/E vetë- motivuar, i aftë të mësojë shpejt, fleksibil dhe i gatshëm të punojë nën presion,
- Shkathhtësi në udhëheqje dhe menaxhim,
- Njohuri të punës me kompjuter (Word, Excel, Access, SPSS, etj),
- Njohuri shumë të mira nga gjuha angleze .

2.Një (1) Udhëheqës i Divizionit të informalitetit dhe llogarive qeveritare

Numri i referencës : ASK-DSLK-002

1.Bën menaxhimin dhe organizimin e punëve të llogarive kombëtare rreth pjesës së informalitetit, për planifikimin, realizimin, dhe mbikëqyrjen e realizimit të procesit të punës sipas afateve të parapara, (realizimi i planit sipas afatit kalendarik, implementimi i metodologjive të reja sipas planit vjetor të paraparë, përmirësimi i kualitetit përmes aktiviteteve shtesë me shpjegime metodologjike), si dhe përpilimi dhe publikimi i Llogarive Qeveritare.

2.Konsulton eksperiencat dhe vë në shfrytëzim standardet dhe metodologjitë Eurostatit (ESA), statistikave të kombeve të Bashkuara (SNA) dhe FMN (GFS) dhe udhëzuesit të Organizatës për Zhvillim dhe bashkëpunim Ekonomik (OECD).

3.Bashkëpunon me sektorët tjerë brenda ASK dhe institucioneve tjera për mbledhjen e të dhënave

4.Punon në përgatitjen e publikimeve të divizionit dhe bën mbikëqyrjen e tyre

5.Kontrollon cilësinë e indikatorëve dhe siguron krahasueshmërinë e të dhënave statistikore të Kosovës me ato ndërkombëtare.

6.Ndihmon stafin për realizimin e detyrave dhe përgjegjës për aftësimin profesional të tyre dhe avancim.

7.Koordinon me projektet e llogarive qeveritare dhe të ekonomisë së pavarëjtuar

8.Kryen detyra të tjera shtesë sipas kërkesës së Drejtorit të departamentit

Kualifikimi: Diplomë universitare nga fakulteti ekonomik .

-Përvoja e punës: Kandidati duhet të ketë 5 vite përvojë pune profesionale

-Kompetenca dhe aftësitë:

- Të munduarit strategjik lidhur me planifikimin dhe menaxhimin
- Njohuri për indikatorët makroekonomik
- Shqyrtimi dhe vlerësimi i rekomandimeve të stafit vartës
- Komunikimi me nivelet e larta brenda dhe jashtë institucionit, për shkëmbimin e informatave dhe përfaqësimin e qëndrimeve të departamentit dhe institucionit rreth çështjeve relevante;
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit, negociuese dhe bindëse në menaxhim dhe shkathtësi në udhëheqje dhe menaxhim të ekipeve
- Njohuri të punës me kompjuter (*Word, Excel etj*)
- Njohuri shumë të mira nga gjuha angleze.

Procedura e konkurimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues në ASK, të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim.

Kërkesat për punësim merren në Zyrën e Arhivës të ASK-së.

Së bashku me formularin për punësim duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës, vlerësimin e fundit të punës si dhe dokumentacione të tjera që lidhen me vendin e punës.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

ASK, ofron mundësi të barabarta të rekrutimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda ASK-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil.

Afati i konkurrimit është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në Web-faqen e ASK dhe në Tabelën e Shpalljeve të ASK.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutem të informoheni me Zyrën e personelit në ASK.